



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:183624

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05728199

KA.nr. 444/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Solution D” SH.P.K., me NUI 810490798, me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini”, SH.P.K., me adresë në lagjen Veternik, Kompleksi EXDC 3, LLamella 10, Kati 6, Nr.18 kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin e vendimit Nr. 10/K-101-20 i datës 23.1.2020, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 02.05.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokate Miranda Haxhiu nga shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini”, SH.P.K., në mungesë të përfaqësuesit të paditurës sipas autorizimit, më datë 16.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Solution D” SH.P.K., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr. 10/K-101-20 i datës 23.1.2020, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Me datë 23.12.2020 paditësi “Solution D” SH.P.K, me seli në Prishtinë, me NUI: 810490798, i përfaqësuar sipas autorizimit nga shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini”, SH.P.K., ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin e vendimit Nr. 10/K-101-20 i datës 23.1.2020, i nxjerrë nga i padituri i Inspektoratit Shëndetësor.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur nga Gjykata Themelore në Prishtinë– Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomat Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 444/22 .

Përfaqësuesi i paditësit avokate Miranda Haxhiu nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu Qerkini në seancën e shqyrtimit kryesor më datë 02.05.2024, në Gjykatën Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative me seli në Prishtinë, ka deklaruar se ndaj vendimit të kundërshtuar me padi ishte bërë edhe një ankesë në bordin e AKPPM-së e dorëzuar më datë 18.12.2020 dhe ky bord si organ i shkallës së dytë ka nxjerr vendim me nr. 01/21 me numër protokolli 4700/2 i datës 08.02.2021, me të cilin ka anuluar vendimin e parë dhe si pasojë e kësaj është kthyer licenca për subjektin, andaj ka deklaruar se nuk kanë më interes juridik të vazhdojnë me padi.

Gjykata duke vepruar sipas deklaratës së paditësit për tërheqje të padisë të konstatuar në seancën e shqyrtimit kryesor më datë 02.05.2024, konstatoj se paditësit i tërheq padinë me deklarin e tij të lirë dhe i vetëdijshëm për pasojat ligjore të tërheqjes së padisë, andaj konform nenit 261 par. 2 dhe par 3 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KP.nr.444/22, datë 16.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.